



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, Neni 13 dhe 14 i Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit parauniversitar, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, pas propozimit të kryetarit të Komunës së Dragash-it në seancën e mbajtur më datë 08.04.2025, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR DREJTOR TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE

Neni 1

Formohet komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që do të konkurrojnë për pozita të drejtorëve në Institucionet Edukativo- Arsimore që janë në vartësi të Komunës, në përbërje prej:

- 1.1 Faton Nafezi – Përfaqësues nga DKA - Kryesues,
- 1.2 Fatmir Mehmeti – Ekspert i pavarur i Arsimit,
- 1.3 Anëtar i tretë vjen nga MASH-ti, sipas udhëzimit administrativ, Nr.151/2020,
- 1.4 Anëtar - dy përfaqësues të këshillit drejtues të institucionit edukativo-arsimor, një prind dhe një mësimdhënës në cilësinë e vëzhguesve pa të drejt vote në secilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Komisioni përzgjedhës, ka për detyrë që të bëjë intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në konkursin për pozita të drejtorit dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe kandidatin më të suksesshëm ja rekomandon Kryetarit të Komunës për emërim në pozitën e drejtorit të shkollës sipas konkursit për shkollat:

1. Sh.M.L “Ruzhdi Berisha” në Dragash,
2. Sh.F.M.U. “28 Nëntori” në f.sh.Brodosanë dhe
3. Sh.F.M.U. “Sezai Surroi” në f.sh. Bellobrad.

Komisioni përzgjedhës është ad hoc dhe mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me këtë konkurs.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-5357-5/25

Dt. 08.04.2025



Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj

A. Skeraj